

Banka e Shqipërisë

# TENDENCAT NË KREDITIM

TREMUJORI IV - 2016

*ERJONA SULJOTI, OLTA MANJANI DHE MEDVIN SHEHU*  
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

JANAR 2017

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.



# P E R M B A J T J A

<i>HYRJE</i>	4
<i>PËRMBLEDHJE</i>	5
<i>1. KREDIA PËR BIZNESE</i>	7
<i>2. KREDIA PËR INDIVIDË</i>	10
<i>3. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT</i>	12
<i>4. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT</i>	16

## HYRJE

Ky material synon të paraqesë një panoramë të tendencave të aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, materiali analizon të dhënat monetare për portofolin e kredisë, si dhe kushtet e kreditimit. Gjithashtu, pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në vendet e Evropës Qendrore Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuar në këtë material janë:

- Të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin rezident të ekonomisë;
- Të dhënat cilësore të marra nga vrojtimi i aktivitetit kreditues;
- Statistikat për çmimin e kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro;
- Të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgari (BU), Kroaci (Cr), Rumani (RO), Serbi (Sr), Poloni (Pl), Hungari (Hu), Çeki (CZ), dhe Maqedoni (IRJM).

Materiali mbulon të dhënat e publikuara deri më 21 janar 2017, të cilat përshijnë informacion për të dhënat monetare dhe financiare për muajin nëntor 2016, dhe të dhënat e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e katërt të vitit 2016.

## PËRMBLEDHJE

**Kredia për sektorin privat** shënoi një rritje vjetore të moderuar prej 3.2% në muajt tetor- nëntor, të ngjashme me tremujorin e tretë. Kjo rritje reflektoi përshpejtimin e normave të rritjes së kredisë në lekë dhe dobësinë e kredisë në valutë. Zgjerimi i portofolit krahasuar me muajin shtator i dedikohet sezonalitetit pozitiv të tremujorit të fundit. Ecuria e kredisë për sektorin privat është mbështetur nga përmirësimi i vazhdueshëm i kredisë për individë, ndërsa rimëkëmbja e aktivitetit kreditues për bizneset mbetet e brishtë.

**Rritja vjetore e kredisë për individë** në muajt tetor-nëntor është më e lartë se ajo në tremujorin e tretë, duke shënuar mesatarisht 5.1%. Kushtet e mira të kreditimit së bashku me përmirësimin e gjendjes financiare dhe besimin e individëve kanë përkrahur zgjerimin e ritmeve të rritjes së kredisë për individë. Ecuria e mirë e kredisë konsumatore ka qenë kontribuuesi kryesor në zgjerimin e portofolit të kredisë së individëve. Ndërkohë, kredia për banesa ka shfaqur një ngadalësim të ritmeve të rritjes, duke reflektuar ecurinë e dobët të kërkesës për banesa nga individët. Zgjerimi i kredisë për individë është mbështetur nga kredidhënia në monedhën vendase.

**Kredia për biznese** vijon të shfaqet e përqendruar dhe me ritme rritjeje të moderuara. Në muajt tetor-nëntor, ritmet e rritjes së këtij portofoli u ngadalësuan në 2.3%, të ndikuara si nga një ofertë e shtrënguar për kredi, ashtu edhe nga një kërkesë e dobët. Kredia për likuiditete ka shfaqur ngadalësim të ritmeve të rritjes, si në terma vjetorë ashtu edhe mujorë. Zgjerimi i kredisë për biznese për këta dy muaj është përcaktuar nga kredia për investime, edhe pse ky portofol ka shfaqur ngadalësim të ritmeve vjetore të rritjes. Ecuria e kredisë për biznese reflekton një kërkesë të segmentuar për financim nga bizneset dhe kushte të shtrënguara financimi nga bankat. Shtërngimin e kushteve në tremujorin e katërt, bankat e kanë zbatuar me forcimin e kërkesave për kolateral.

**Normat e interesit të kredisë së re në lekë** në muajt tetor-nëntor janë lehtësisht më të larta se në tremujorin e tretë, të ndikuara nga rritja e normave të interesit në segmentin afatshkurtër dhe kryesisht për bizneset. Ndërkohë, interesat e kredive në euro kanë qenë të qëndrueshme për bizneset dhe kanë shënuar rritje për individët. Kushtet e tjera joçmim të kreditimit janë shtrënguar për bizneset në kërkesat për kolateral, ndërsa ato kanë qenë në kahun lehtësues për kredite e individëve.

Kredia për sektorin privat në **vendet e rajonit të EQJL-së** gjatë tremujorit të fundit ka ndjekur trajektore të ngjashme me pjesën e mëparshme të vitit, duke regjistruar norma rritjeje të moderuara. Në terma rajonalë, ngadalësimi i kredisë gjatë këtij tremujori është përcaktuar kryesisht nga ecuria e kredisë

në vendet e Evropës Qendrore. Ndarja sipas agjentëve ekonomikë tregon se pjesa më e madhe e zgjerimit të kredisë për sektorin privat gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016 është formuar nga rritja e kredisë për individë. Kjo e fundit ka regjistruar norma të qëndrueshme rritjeje, si në vendet e Ballkanit ashtu edhe ato të Evropës Qendrore.

#### *HAPËSIRË INFORMUESE: NDRYSHIME METODOLOGJIKE NË STATISTIKAT MONETARE DHE FINANCIARE*

Krahas funksionit të saj kryesor në hartimin, zbatimin dhe miratimin e politikës monetare në vend, Banka e Shqipërisë luan një rol të rëndësishëm në përpunimin dhe publikimin e statistikave monetare dhe financiare. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë është në një proces të vazhdueshëm të përmirësimit dhe pasurimit të të dhënave statistikore. Gjatë vitit 2016, Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë ka ndërmarrë hartimin dhe publikimin e të dhënave monetare dhe financiare sipas një standardi të ri metodologjik, si dhe ka finalizuar aplikimin në praktikë të një sistemi të automatizuar të grumbullimit të të dhënave. Të dy këta faktorë kanë ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së statistikave si dhe në përafrimin e tyre me kuadrin statistikor evropian ESA 2010<sup>1</sup>.

Ndryshimet metodologjike kanë në qendër (ri)klasifikimin e sektorëve institucionalë, detajimin e nënsektorëve dhe instrumentave instrumenteve kryesore financiare. Më konkretisht, klasifikimi sipas sektorëve institucionalë konsiston, dhe ka si kundërpanti, instrumentat instrumentet financiare sipas sektorëve të ekonomisë. Klasifikimi i sektorëve bazohet në detajimin dhe saktësimin e nënsektorëve përbërës dhe veprimtarinë e tyre. Për ta ilustruar, sektori i korporatave jofinanciare ndahet në nënsektorët: korporata jofinanciare private dhe publike. Këto njësi institucionale janë subjekte juridike të pavarura dhe veprimtaria kryesore e tyre është prodhimi i mallrave dhe shërbimeve jofinanciare. Në të njëjtën mënyrë, korporatat financiare përbëhen nga banka qendrore, korporatat e tjera depozituese, fondet e investimit, ndërmjetësit e tjerë financiarë përveç kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit, ndihmësit financiarë, kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensionit, të cilët kryejnë funksione financiare<sup>2</sup>.

Në nëntor të vitit 2016, u publikuan për herë të parë të dhënat me standardin e ri, të cilat i përkasin të dhënave monetare dhe financiare për muajin shtator. Në këtë publikim u rishikua sipas metodologjisë së re e gjithë periudha dhjetor 2015- shtator 2016. Për t'i shërbyer sa më mirë analizës dhe vendimmarrjes së politikës monetare, zgjatja e serive përpara kësaj periudhe është kryer nëpërmjet vlerësimit me metodën statistikore që i përafron ato më mirë me dinamikën në vitet e mëparshme. Për këtë arsye, si dhe për shkak të (ri)klasifikimeve të lartpërmendura, disa prej treguesve monetarë dhe financiarë reflektojnë ndryshime të vlerave, kryesisht në të dhënat e huave, depozitave, normave të interesit, si dhe treguesve të ndërtuar mbi to. Megjithë këto ndryshime, standardi i ri metodologjik nuk ndikon në mënyrë të qenësishme tablonë dhe tendencat e treguesve monetarë dhe financiarë.


<sup>1</sup> Ndryshimet metodologjike janë konform "Metodologjisë së Sistemit Evropian të Llogarive ESA 2010", "Udhëzuesit të hartimit të statistikave monetare dhe financiare, FMN 2008", "Manualit të statistikave monetare dhe financiare, FMN 2000" dhe "Metodikës së statistikave monetare dhe Financiare, Banka e Shqipërisë, korrik 2003".

<sup>2</sup> Detaje të mëtejshme përfshihen në materialin "Shpjegues metodologjik për statistikat monetare dhe financiare", në adresën: [https://www.bankofalbania.org/web/pub/statistikat\\_monetare\\_dhe\\_financiare\\_sipas\\_standardit\\_te\\_ri\\_2\\_8906\\_1.pdf](https://www.bankofalbania.org/web/pub/statistikat_monetare_dhe_financiare_sipas_standardit_te_ri_2_8906_1.pdf)

## 1. KREDIA PËR BIZNESE<sup>3</sup>


Kredia për biznese ka ngadalësuar ritmet e rritjes në mesatarisht 2.3% mesatarisht për muajt tetor-nëntor. Megjithatë, dinamika afatshkurtër tregon se flukset neto për këtë periudhë janë më të larta se në tremujorin e tretë, sikurse pritej edhe nga sjellja sezonale e saj. Këto zhvillime konfirmojnë që kredia për biznese mbetet e brishtë dhe e kushtëzuar si nga një ofertë e shtrënguar për kredi nga banka, ashtu dhe nga një rikuperim i ngadaltë i kërkesës për financim. Kushtet e kreditimit vijojnë të jenë të shtrënguara për biznesin e madh, ndërsa kanë mbetur të pandryshuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Bankat presin që një situatë e ngjashme të vazhdojë edhe në tremujorin e parë të vitit 2017.

Përmirësimi i aktivitetit ekonomik në vend dhe rikuperimi i besimit të bizneseve në disa nga sektorët e ekonomisë është reflektuar në një kërkesë më të lartë për financim nga bizneset pranë bankave. Gjithsesi, kërkesa mbetet ende e ulët dhe përballë një oferte të shtrënguar të bankave ka përcaktuar një trajektore të luhatshme të portofolit të kredisë për biznese. Rritja e kredisë për biznese prej 2.3% në muajt tetor- nëntor është 0.6 pikë përqindje më pak se një tremujor më parë. Megjithatë, krahasuar me muajin shtator, ky portofol u rrit me rreth 4.5 miliardë lekë duke sinjalizuar për një përmirësim të flukseve neto, në linjë me sjelljen sezonale të fundvitit.



<sup>3</sup> Të dhënat e kredisë për biznese përjashtojnë efektin e kredive të riklasifikuara në zërat jashtë bilancit.


Ecuria pozitive e kredisë për biznese është mbështetur nga kreditimi në lekë. Norma vjetore mesatare e këtij portofoli është përsheptuar në dy muajt e fundit në 9.1%, përkundrejt vlerës 6.2% të shënuar një tremujor më parë. E gjithë kredia e dhënë në këto dy muaj ka qenë në lekë, duke kompensuar dhe tkurrjen e kredisë në valutë për biznese. Në terma vjetorë kredia në valutë u tkurr mesatarisht me 1.3%. Në fund të muajit nëntor, kredia në lekë përbënte rreth 36.5%, ose 2.2 pikë përqindje më e lartë se në vitin 2015. Zhvendosja e portofolit të bizneseve drejt kreditimit në lekë lidhet si me uljen e kostos së financimit përgjatë vitit, ashtu edhe me natyrën e përdorimit të këtyre fondeve, kryesisht për likuiditet. Në krahasim me një vit më parë, vihet re, që gjatë këtij viti, kreditimi në lekë i bizneseve është përdorur edhe për të mbuluar financimin e investimeve.



Ngadalësimi i ritmeve të rritjes së kredisë për biznese ka reflektuar norma më të ulëta rritjeje si të kredisë për qëllime likuiditeti, ashtu edhe të asaj për investime. Normat vjetore të rritjes së këtyre portofoleve shënuan mesatarisht 3.1% dhe 1.5% respektivisht në muajt tetor-nëntor, përkundrejt 4.3% dhe 2.0% në tremujorin e tretë. Megjithatë, zgjerimi i portofolit në këta dy muaj është ndikuar plotësisht nga rritja e kredisë për investime, ndërsa niveli i kredisë për likuiditet mbeti i pandryshuar me atë të muajit shtator. Në fund të muajit nëntor, kredia për qëllime likuiditeti përbën rreth 45.5% të totalit të kredisë për biznese dhe është luhatur në këto nivele përgjatë gjithë vitit.



Grafik 3. Kontributi në vlerën e shtuar dhe në kredinë për biznese sipas sektorëve të ekonomisë\*



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.


\*Të dhënat e vlerës së shtuar janë deri në T3, ndërsa kredia sipas sektorëve është deri në nëntor 2016.

Në tremujorin e katërt kredia dhënë bizneseve ka mbështetur sektorin e shërbimeve dhe më pak atë të ndërtimit, ndërkohë që kredia për sektorin e industrisë dhe atë bujqësor është tkurrur. Dinamika vjetore e këtyre portofoleve tregon se norma e rritjes së kredisë për sektorin e tregtisë, hoteleve dhe restoranteve është ngadalësuar në mesatarisht 1.4%, krahasuar me 2.8% në tremujorin e tretë. Ndërkohë, kredia për "shërbimet e tjera" ka mbajtur ritmet e të larta rritjeje prej 10.4%. Kredia për sektorin e ndërtimit ka shfaqur rritje me 1.2%, më të lartë se norma 0.8% të shfaqur një tremujor më parë. Në muajt tetor-nëntor vihet re se kredia për sektorin e industrisë dhe bujqësisë është tkurrur në terma vjetorë me përkatësisht -1.9% dhe -4.8%. Këto zhvillime duken të reflektojnë si ecurinë e aktivitetit ekonomik, ashtu edhe të treguesve të besimit gjatë vitit 2016.

## 2. KREDIA PËR INDIVIDË<sup>4</sup>

Kredia për individë ka përmirësuar normat e rritjes edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit. Kjo ecuri ka reflektuar lehtësimin për disa tremujorë radhazi të kushteve të kreditimit për këtë segment, si dhe rritjen e kërkesës së individëve për kredi. Zgjerimi i tij në terma vjetorë është mbështetur si nga rritja e kredisë konsumatore, ashtu edhe nga kredia për blerje banese. Bankat janë shprehur optimiste edhe për zhvillimet e pritshme në tremujorin e parë të vitit 2017, teksa parashikojnë lehtësim të mëtejshëm të kushteve të kreditimit dhe rritje të kërkesës nga individët.


Kredia për individë ka shfaqur përmirësim të ritmeve të rritjes edhe në tremujorin e fundit të vitit, duke shënuar një normë vjetore prej rreth 5.1% në muajt tetor-nëntor, krahasuar me normën mesatare prej 3.7% në tremujorin paraardhës. Zgjerimi i portofolit të kredisë për individë është mbështetur si nga ana e kërkesës për kredi, ashtu edhe nga kushtet e përmirësuara të ofertës. Kërkesa për kredi nga individët është nxitur nga forcimi i besimit konsumator, nga përmirësimi i kushteve në tregun e punës, si edhe nga rritja e të ardhurave të disponueshme. Në të njëjtën kohë, lehtësimi i vazhdueshëm i kushteve të kreditimit nga sistemi bankar ka favorizuar më tej kredihënien në këtë segment.



<sup>4</sup> Të dhënat e kredisë për individë përjashtojnë efektin e kredive të riklasifikuara në zërat jashtë bilancit.

Zhvillimet pozitive të kredisë për individë kanë reflektuar zgjerimin e kredisë për konsum, si në terma mujorë ashtu edhe në terma vjetorë. Ky portofol u shtua me rreth 11.4% në muajt tetor-nëntor, duke shënuar përmirësim të normës vjetore me 2.7 pikë përqindje nga tremujori i kaluar. Portofoli i kredisë për banesa ka shfaqur ngadalësim në normat vjetore të rritjes gjatë muajve tetor-nëntor, në 3.3%, kundrejt mesatares prej 3.6% në tremujorin e tretë të vitit. Kjo ecuri ka reflektuar reduktimin e stokut të kredisë në terma absolutë në muajt tetor dhe nëntor.

Kreditimi në monedhë vendase vijon të mbështesë plotësisht zgjerimin e kredisë për individë. Stoku i kredisë në lekë shënoi rritje mesatare vjetore me 10.8% në muajt tetor-nëntor. Kreditimi në lekë është mbështetur si nga normat e ulëta të interesit, ashtu edhe nga ndërgjegjësimi i individëve për rrezikun e kursit të këmbimit. Nga ana tjetër, portofoli i kredisë në valutë është tkurrur në terma nominalë. Ecuria e këtij të fundit në periudhën tetor-nëntor është ndikuar nga njëra anë nga forcimi i ndjeshëm i lekut ndaj monedhës euro, dhe nga ana tjetër nga nënçmimi i lekut ndaj dollarit amerikan, zhvillime të cilat kanë vepruar në kahe të kundërta dhe në masë të ndryshme. Korrigjuar për këto efekte, portofoli i kredisë për individë në valutë ka mbetur thuhetse në të njëjtat nivele me një vit më parë.




### 3. ÇMIMI I KREDISË DHE KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT

*Normat e interesit të kredisë në muajt tetor dhe nëntor janë rritur lehtas, duke reflektuar kryesisht zhvillimet dhe luhatshmërinë në maturitetet afatshkurtra. Në të kundërt, interesat e kredisë afatgjatë për qëllime investimi kanë shfaqur ecuri rënëse. Normat e interesit në lekë kanë rënë lehtësisht për individët dhe janë rritur për bizneset. Ndërkohë, interesat e kredive në euro kanë qenë të qëndrueshme për bizneset dhe kanë shënuar rritje për individët. Krahas normave më të ulëta të interesit për individët, bankat kanë ofruar edhe kushte më të mira jo-çmim për kreditë e dhëna. Ndërsa për bizneset vihet re shtrëngim i kërkesave për kolateral.*

Norma mesatare e interesit të kredisë në lekë në muajt tetor dhe nëntor shënoi respektivisht 8.21% dhe 7.64%, duke regjistruar rritje nga tremujori i kaluar. Sipas maturitetit, rritja është formuar tek normat e interesit për kreditë afatshkurtra, ndërkohë që ato me maturitet të gjatë janë ulur. Në terma mesatarë, interesi në këta dy muaj është 0.41 pikë përqindje më i lartë se në tremujorin e tretë të vitit dhe afërsisht në të njëjtin nivel me një vit më parë. Normat e interesit të kredisë së re në euro shënuan 4.91% dhe 4.59% përkatësisht në muajt tetor dhe nëntor, duke mbetur në nivele pothuajse të njëjta me mesataren e tremujorit të tretë. Kjo ecuri ka reflektuar rritjen e interesave në segmentin e kredisë afatshkurtër, e cila u kompensua nga ulja e interesave tek maturiteti afatmesëm dhe ai afatgjatë.

Norma mesatare e interesit për kredinë e re në lekë për bizneset në muajt tetor dhe nëntor është rritur me rreth 0.44 pikë përqindje nga tremujori i tretë. Sipas qëllimit të përdorimit, normat e interesit janë rritur për kreditë për overdraft dhe për çelje biznesi. Ndërkohë, ato janë ulur për kreditë për kapital qarkullues dhe investime. Analiza e pastruar nga efekti dhe pesha e një banke të veçantë tek segmenti i overdraftit paraqet një tablo të kundërt, ku normat e interesave për kredinë e dhënë bizneseve janë në rënie. Zgjerimi i horizontit të analizës për të gjithë vitin tregon se normat e interesit për kreditë në lekë për biznese në intervalin tetor-nëntor kanë frenuar uljen dhe luhaten afërsisht tek mesataret e 9-mujorit. Në terma vjetorë, normat e interesit të kredisë të aplikuara për bizneset kanë shënuar rënie (-0.2 pikë përqindje), e cila ka qenë më e theksuar tek kredia për investime. Norma e interesit të kredisë për likuiditet formohet kryesisht nga ajo e overdraftit, e cila është kredi me norma të larta dhe të luhatshme interesi.


Grifik 6. Ecuria e normave të interesit në lekë dhe euro për bizneset



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e interesit për kredinë e re në euro për bizneset në muajt tetor dhe nëntor është ulur lehtës me rreth 0.03 pikë përqindje nga tremujori i tretë. Sipas qëllimit të përdorimit, normat e interesit kanë shfaqur rënie për kreditë për investim dhe kanë rezultuar në rritje për kreditë për overdraft. Ndërkohë, ato kanë mbetur thuajse të pandryshuara për kreditë për kapital qarkullues dhe janë rritur për kreditë për blerje pajisjesh. Gjatë vitit 2016, norma mesatare e kredisë në euro për biznese është më e ulët me 0.71 pikë përqindje kundrejt vitit 2015 dhe me 1.7 pikë përqindje kundrejt vitit 2014. Reduktimi i saj është i pranishëm në të gjitha llojet e financimit në euro për biznese.


Grifik 7. Ecuria e kushteve të kreditimit për bizneset (balanca neto\*)



\*Balanca neto pozitive tregon lehtësim të kushteve dhe anashjelltas. Burimi: Banka e Shqipërisë.


Në tremujorin e katërt, bankat kanë shtrënguar standardet e kreditimit për bizneset e mëdha dhe i kanë mbajtur ato të pandryshuara për bizneset e vogla dhe të mesme. Sipas qëllimit të përdorimit, shtrëngimi ka qenë i pranishëm për të gjitha llojet e financimit. Elementi nëpërmjet të cilit është realizuar shtrëngimi i standardeve ka qenë rritja e kërkesave për kolateral. Ky standard vijon të shtrëngohet për më shumë se një vit, në reflektim edhe të vështirësive që hasin bankat në ekzekutimet e kolateraleve të kredive të humbura. Elementet e tjera jo-çmim, si komisionet, maturiteti i kredisë apo marzhi mesatar rezultojnë në kahun lehtësues të standardeve të kreditimit, por në një masë të vogël.

Norma mesatare e interesit për kreditë në lekë për individë në muajt tetor dhe nëntor ka mbetur thuajse e pandryshuar; ajo rezultoi 0.04 pikë përqindje më e ulët se në tremujorin e tretë të vitit. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, norma më të ulëta janë regjistruar për kreditë overdraft, kreditë për konsumin e mallrave të qëndrueshme dhe kreditë për pasuri të paluajtshme. Rritje ka pësuar norma e interesit për kreditë dhënë individëve për konsumin e mallrave jo të qëndrueshme. Mesatarisht për periudhën korrik- nëntor 2016, norma e interesit për kreditë në lekë për individë është 0.45 pikë përqindje më e ulët se gjysma e parë e vitit, si dhe 1.76 pikë përqindje më e ulët se në vitin 2015. Reduktimi i normave të interesit vijon të jetë më i fortë për kreditë për konsum dhe për ato hipotekare, dhe më pak për kreditë overdraft dhe për ato për ushtrim aktiviteti.



Normat e interesit për kreditë në euro janë rritur lehtës për individët. Në muajt tetor dhe nëntor, norma mesatare e interesit për këto kredi rezultoi mesatarisht 0.33 pikë përqindje më e lartë se në tremujorin e tretë të vitit. Rritja e normave të interesit ka qenë e pranishme tek kategoria e konsumit për mallra të qëndrueshme dhe për ushtrim aktiviteti, ndërkohë interesat për overdraft janë ulur. Në terma mesatarë, norma e interesit për kreditë hipotekare nuk

ndryshoi këto dy muajt, por mbetet gjithsesi në nivele të ulëta historike. Sikurse edhe për kreditë në lekë, normat e interesit për kreditë në euro gjatë vitit 2016 janë më të ulëta se vitin e kaluar, por në një masë më të vogël. Interesi mesatar për 11-muajt e parë të këtij viti rezulton 1.0 pikë përqindje më i ulët se në vitin 2015 dhe 1.37 pikë përqindje më i ulët se në vitin 2014.




Diferenca e normave të interesit për kreditë në lekë kundrejt atyre në euro në segmentin e individëve vijon të ngushtohet. Për periudhën tetor-nëntor, kjo diferencë ka rezultuar 2.5 pikë përqindje nga 2.9 pikë përqindje në tremujorin e tretë. Në terma mesatarë për vitin 2016, ajo është 0.6 pikë përqindje më e ulët se në vitin 2015. Ngushtimi i kësaj difference ka përkrahur rritjen e portofolit të kredisë në lekë për individë veçanërisht në kredinë hipotekare. Për këtë kredi, diferenca e normave të interesit në muajt e fundit shpesh herë është luhatur nën zero, duke reflektuar një zvogëlim të mëtejshëm të interesave për kredi hipotekare në lekë.

Në tremujorin e katërt të vitit, bankat vazhdojnë të lehtësojnë kushtet e kreditimit për individët. Ky lehtësim është përcaktuar nga lehtësimi i kushteve për kredinë konsumatore, ndërkohë që bankat kanë lënë të pandryshuara kushtet për kredinë hipotekare. Për lehtësimin e kushteve të individëve bankat kanë përdorur jo vetëm çmimin e kredisë, por dhe të gjitha elementet e tjera joçmim. Ky lehtësim vërehet më shumë në uljen e marzhit mesatar të kredisë, rritjen e raportit të këstit ndaj të ardhurave, në madhësinë dhe maturitetin e kredisë, si dhe në uljen e komisioneve.

## 4. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT

*Ecuria e kredisë në vendet e rajonit të EQJL-së ka vijuar të shfaqë norma më të përmbajtura rritjeje edhe gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016<sup>5</sup>. Rritja e kredisë në këtë rajon udhëhiqet nga rajoni i Evropës Qendrore, ecuria e të cilit ka diktuar më së shumti edhe normat ngadalësuese të muajve të fundit. Rritja e kredisë për sektorin privat në rajonin e Ballkanit ndonëse më e qëndrueshme, shfaqet në nivele më të ulëta. Zhvillimet e kredisë sipas agjentëve ekonomikë karakterizohen nga norma më të shpejta rritjeje të kredisë për individë.*

Stoku i kredisë për sektorin privat në vendet e rajonit të EQJL-së u zgjerua me rreth 3.6% në muajt tetor-nëntor, krahasuar me normën prej rreth 4.1% në tremujorin e tretë të vitit. Në terma rajonalë, ky ngadalësim është diktuar si nga ecuria e kredisë në Evropën Qendrore, ashtu dhe në rajonin e Ballkanit. Vrojtimet e aktivitetit kreditues në vendet e rajonit të EQJL-së për gjysmën e dytë të vitit 2016 tregojnë se kushtet e kreditimit nga ana e ofertës kanë mbetur gjerësisht të pandryshuara, përkundrejt perceptimit për përmirësim të kërkesës<sup>6</sup>. Kjo ecuri ka thelluar më tej hendekun midis kërkesës dhe ofertës. Ndryshimet në kuadrin rregullator, kushtëzimet në kapitalin e bankave dhe kreditë me probleme në nivel grupi raportohen ndër faktorët kryesorë me ndikim në shtërngimin e kushteve të ofertës në kredihënie. Nga ana tjetër, kërkesa për kredi ka vijuar të rritet dhe faktorët që e ndikojnë atë raportohen me kontribut pozitiv, duke mbështetur zgjerimin e kredisë në rajonin e EQJL-së.




<sup>5</sup> Analiza e të dhënave monetare dhe financiare për vendet e rajonit përfshin muajt tetor dhe nëntor 2016.

<sup>6</sup> Vrojtimi i aktivitetit kreditues në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore, Gjashtëmuji I, 2016. [http://www.eib.org/attachments/efs/economics\\_cesee\\_bls\\_2016\\_h2\\_en.pdf](http://www.eib.org/attachments/efs/economics_cesee_bls_2016_h2_en.pdf)




Zhvillimet në terma rajonale vijojnë të tregojnë ecuri relativisht të segmentuar, ku peshën kryesore të rritjes së kreditimit në rajonin e gjerë të EQJL-së e mban Evropa Qendrore. Megjithatë, ngadalësimi i ritmeve të kreditimit në këtë rajon në muajt e fundit, paralelisht me një prirje të lehtë në rritje të kreditimit në vendet e Ballkanit, kanë ndikuar në ngushtimin e hendekut midis ecurisë së kredidhënies në këto dy rajone. Ngadalësimi i normave të kredisë në rajonin e Evropës Qendrore është ndikuar kryesisht nga thellimi i tkurrjes së kredisë në Hungari, së bashku me normat më të përmbajtura të rritjes të regjistruara në Poloni dhe Çeki gjatë muajve tetor-nëntor. Zhvillimet në rajonin e Ballkanit reflektojnë ecurinë pozitive të kredidhënies në Rumani, Bullgari e Serbi. Për sa i përket Shqipërisë, ajo renditet mirë në terma të normave të rritjes së kredisë për sektorin privat, e cila rezulton më e shpejtë se mesatarja e vendeve të Ballkanit në terma vjetorë.



Portofoli i kredisë për biznese shënon rritje të qëndrueshme në vendet e Evropës Qendrore. Vrojtimi i aktivitetit kreditues në rajonin e gjerë të EQJL-së raporton për kushte lehtësisht të përmirësuar për kreditë për ndërmarrjet e mëdha. Ecuria e kredisë për biznese vijon të mbetet në territor negativ për rajonin e Ballkanit, ndonëse më e zbutur krahasuar me tremujorin e tretë të vitit. Kredia për biznese në Shqipëri shënon rritje me norma të ulëta, por relativisht të qëndrueshme.

Grafik 12. Kredia për individë në vendet e rajonit



Kredia për individë udhëheq zgjerimin e portofolit të kredisë për sektorin privat. Ecuria e saj rezulton e qëndrueshme, si në vendet e rajonit të Evropës Qendrore, ashtu edhe në vendet e Ballkanit. Sipas vrojtimit të aktivitetit kreditues në EQJL-së, faktorë të tillë si besimi konsumator, zhvillimet në tregun e banesave dhe shpenzimet e konsumit jo për banesa kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e kërkesës së individëve për kredi.